



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

-Sektori i Kuvendit-

01Nr. 60/01-15932/21
Kaçanik, 15.06.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI-të (Gjashtë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 15.06.2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye anëtari, Sali Malsiu.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Ramadush Osmani, Festim Neziraj, Fatmir Loku, Bahri Selimi, Ukshin Qallaku, Diana Reka dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka, Fatlume Guri-Selimi.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Gazmend Murseli.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje. Pjesëmarrës të kësaj mbledhje po shihet së janë të gjithë me përjashtim të Sali Malsiu i cili mungon me arsye. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VI-të (Gjashtë) të Rregullt për vitin 2021, data 15 Qershor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës kadastrale 01003-0, me kulturë Oborr ZK Kaçanik, në emër të Misim Sopa, për Këmbim me pronën komunale me pjesën e parcelës kadastrale 01030-0, me kulturë P.SH. Rrugët publike dhe të pa kategorizuara, ZK Kaçanik;
3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër;

4. Ftesa e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Strugës, për një vizitë zyrtare të Këshilltarëve të KK Kaçanik, në Komunën e Strugës.

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 4 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së V-të (Pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 28/05.2021 / Lënda: 01Nr.60/01-13805/21.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pikët e dytë, procedojmë me ;

Pyetje dhe Kërkesa

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues, Përshëndetje për të gjithë; E kam një pyetje për kryetarin; Në rrugën A2, a ka diçka të re?, Në këtë rrugë është punuar një kohë prej ministrie dhe ka kohë që kanë ngecë punimet. Nuk e di a është bërë diçka në këtë drejtim ?

2. Edhe një pyetje ose kërkesë për DSHPE; Dihet së parkingjet të dielave nuk paguhen. Kishte me qenë mirë që kjo të bëhet edhe për festa. Më herët edhe për festa nuk janë paguar parkingjet. Kërkoj të rregullohet kjo çështje, në mënyrë që qytetarët të mos paguajnë për parkingje në ditët e festave.

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues, iu përshëndes të gjithëve, Pyetja ime është: Të "BK" e kam parë që operatori ekonomik jep motorë elektrik me qira. Problemi është së aty shihen edhe fëmijët nën moshat 7 e 8 vjeçare për me marrë motor me qira. Nuk është kompetencë e juaja, por është mirë me lajmëruar policinë që me ndërprejnë atë aktivitetet së paku për fëmijët e moshave të vogla, sepse mund të ndodhë ndonjë aksident.

z. Bekim Koxha, Faleminderit, përshëndetje për të gjithë; Të pyetjet të cilat i kemi ngritur në mbledhjen e kaluar, përgjigjet të cilat na janë kthyer, janë kthyer vetëm sa për të qenë, pa dhënë informacione konkrete:

Të pyetja për kubëzat, nuk janë dhënë detajet qysh kam kërkuar. Pse nuk jepen emrat kush ka përfutur kush ka marrë, ku janë investuar ato kubza ? Këtu nuk është dhënë përgjigje.

Të fillimi i rrugës Koxhaj, është dhënë një përgjigje, por është gjysmake. Nuk është dhënë ndonjë afat, në cilën datë do të filloj ndërtimi i asaj rruge.

Nga drejtori i drejtorisë së Bujqësisë, të pyetja e cila është bërë për kanalin e ujitjes, desha një informim pak me të gjerë këtu para KK; Përse është dhënë përgjigje se nuk ka ankesa të qytetarëve që iu kanë drejtuar kësaj drejtorie. Në bazë të takimeve të cilat i kam pasur me

qytetarë, dhe informatave tjera që kam, qytetarët janë deklaruar së kanë pasur ankesa edhe të drejtori, ndërkaq nuk janë marrë masa nga ky organ.

Të rruga e staneve, është thënë së nuk mundemi me ndihmuar atë rrugë, sepse është pronë e pylltarisë në nivel qendror. Unë mendoj që duhet si komunë të dilet dhe t'iu ndihmohet, ajo rrugë është ekzistuese dhe të riparohet pak a shumë ajo rrugë që të bëhet e kalueshme, e mos të ndodhë ndonjë fatalitet, së më të vërtetë është gjendje e mjerueshme me dal në atë rrugë.

Nuk e di a ka dal drejtori a e ka vizituar kush atë rrugë së në çfarë gjendje është.

Në rregullimin për të varrezat e dedeve, të pyetja e cila e kam për rrugën që po shtrohet prej fabrikës së "Silcaporit", aty nuk janë marrë masa dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje.

Pyetje të reja;

1. Të hidrocentralet, objekti i hidrocentraleve, është çështje që i shqetëson më së shumti banorët-komunitetin e f. Doganaj. Hidrocentrale janë katastrofë. Është dhënë leje për hidrocentrale dhe nuk e di së kush e ka dhënë atë leje? Unë mendoj se dikush duhet të shkon në përgjegjësi. Të anashkalohet KK e të formohet komision për dhënie të lejes, unë nuk e kuptoj këtë. Unë nuk e kuptoj se kush ka pasur atë guxim me marrë këtë lëndë në komision e mos me ardhur lënda në KK me iu dhënë dikujt leja për hidrocentrale në lumin Lepenc.

2. Pyetja tjetër është për drejtorin e DAK; Shkolla fillore në f. Koxhaj, dihet së është në gjendje të mjerueshme. Ka pasur bisedime që atje të intervenohet, nuk është intervenuar, Kërkoj që mos të lihet në atë gjendje ajo shkollë, së më të vërtetë është në gjendje të keqe me u parë nga secili qytetar. Unë nuk e di se kush e ka sjellë në atë gjendje, dihet së qytetarët e kanë demoluar dhe shkatërruar, mirëpo duhet të merren masa dhe të riparohet dhe mos të jetë një vend aty që po shihet së po shkojnë të rinjtë aty dhe po bëjnë aktivitete jo të hijshme, kështu që është mirë me intervenuar me u sanuar gjendja e shkollës.

3. Desha edhe një pyetje për kryetarin, për intervenime të cilat janë duke u bërë në fabrikën e gëlqeres. A është në dijeni kryetari për këtë çështje dhe çka parashihet të ndërtohet aty ? A ka ndonjë ide ai që e ka privatizuar se çka ka me u bërë aty? A ka të drejtë pronari me ndërruar destinimin e saj ? Kërkoj informacione me të hollësishme rreth kësaj çështje ?

znj. Hafize Sallahi, Përshëndetje për të gjithë; Unë nuk kam ndonjë pyetje, por edhe pse jeni në dijeni,

Unë publikisht iu njoftoj se tani jam pjesë e subjektit të AAK, dhe kërkoj nga kryesuesi të më zëvendësoj edhe në KPF, meqë ajo ulëse i takon subjektit politik- NISMA.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkoj nga znj. Hafize Sallahu të adreson edhe me shkrim tek Sekretaria e KK një Deklaratë për kalimin në subjekt tjetër politik (nga NISMA në subjektin politik AAK). Pyetje dhe kërkesa të tjera nuk ka, atëherë kalojmë në pikën e radhës:

2. Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës kadastrale 01003-0, me kulturë Oborr ZK Kaçanik, në emër të Misim Sopa, për Këmbim me pronën komunale me pjesën e parcelës kadastrale 01030-0, me kulturë P.SH. Rrugët publike dhe të pa kategorizuara, ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka rreth këtij Propozim Vendimit, drejtori është këtu për sqarime të nevojshme, lë të urdhëroj:

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues: Edhe në mbledhjen e KPF kemi debatuar mjaft për këtë çështje. E di së aty ekziston një vendim gjyqësor, dhe është mirë paraprakisht që ai problem së pari të zgjidhet mes të fqinjëve pastaj t'i adresohet Kuvendit të Komunës kjo çështje. Ne subjekti politik i LVV do të abstenojmë kur të votohet kjo pikë, sepse konsiderojmë që sido që të votojmë, kjo çështje sjell kok-qarje.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse nuk ka kush diçka, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 11 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 15 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës kadastrale 01003-0, me kulturë Oborr ZK Kaçanik, në emër të Misim Sopa, për Këmbim me pronën komunale me pjesën e parcelës kadastrale 01030-0, me kulturë P.SH. Rrugët publike dhe të pa kategorizuara, ZK Kaçanik.

3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër;

Kryesuesi i Kuvendit, Është një Propozim Vendim i cili ka ardhur nga Ekzekutivi i Komunës, Komisioni duhet themelohet nga KK, por sa po e shoh unë, është shpallë data e zgjedhjeve dhe Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronave komunale e përcakton çështjen e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale kur kemi të drejtë dhe kur jo me dhënë prona në shfrytëzim. Ne mund të formojmë këtë komision, pastaj të shqyrtohet çështja e ligjshmërisë se a kemi të drejtë me vepruar apo jo me marrë këtë vendim. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Ne LVV konfirmojmë së nuk kemi kandidat për anëtar të këtij komisioni. Konsideroj së ky komision do të jetë jofunksional, duke marrë parasysh se me duket së nuk është bërë pranimi teknik i objektit në fjalë. Po ashtu ndërtimi i këtij objekt ka pasur shumë telashe, siç e ka thënë edhe kryetar, së lënda është në krime ekonomike. Ne LVV do të abstenojmë kur të dal në votim kjo pikë.

Kryesuesi i Kuvendit, Megjithëse ajo që po thoni, nuk e di a ndërlidhet me këtë çështje, sepse ato janë procedura të tjera, megjithatë ne do ti kryejmë obligimet tona. Se çka ka ndodhur aty, janë organet tjera që i zhvillojnë procedurat, se edhe ashtu nuk mundemi me lënë atë objekt. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë kërkoj nga 3 subjektet politike me të mëdha të dalin me propozimet e tyre (të japin nga 1 emër për anëtarë të komisionit) ?

z. Nexhat Loku, Faleminderit kryesues; Në emër të GP të PDK e propozoj z. Kadri Krivenjeva për anëtar të komisionit.

Kryesuesi i Kuvendit, LVV është deklaruar së nuk kemi kandidatë, atëherë vazhdojmë me subjektin politik -LDK.

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues; Nga GP i subjektit politik të LDK e propozojmë për anëtar të komisionit, Besnik Salihu.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkojmë nga AAK të jep propozimin e saj për 1 anëtarë të komisionit.

znj. **Rabije Sallahi**, Në emër të AAK e propozojmë për anëtar të komisionit, Hafize Sallahi.

Kryesuesi i Kuvendit, Nga Ekzekutivi i Komunës kërkoj propozimin për një anëtar të komisionit.

Kryetari i Komunës – Besim Ilazi, Nga Ekzekutivi i Komunës e propozojmë, Xhelal Gashi, ndërkaq nga OJQ të dala nga lufta, ka ardhur emri i Rustem Dema - OVL e UÇK-së.

Kryesuesi i Kuvendit, Propozimet të cilat dolën i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtat u aprovuan me shumicën e votave Për, Kundër votë ishin 8 anëtarë, Abstenoj Ekrem Raka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër, në përbërje:

1. Kadri Krivenjeva, anëtar i KK nga PDK,
2. Besnik Salihu, anëtar i KK nga LDK,
3. Hafize Sallahu, anëtare e komisionit nga AAK;
4. Xhelal Gashi, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës; dhe
5. Rustem Dema nga sektori jo qeveritar/ OVL e UÇK.

Lënda: 01Nr. 60/01-15789/21.

4. Ftesa e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Strugës, për një vizitë zyrtare të Këshilltarëve të KK Kaçanik, në Komunën e Strugës;

Kryesuesi i Kuvendit, Ne e kemi diskutuar këtë çështje edhe më herët, e kemi edhe me Planin e punës së KK të planifikuar këtë vizitë zyrtare. Është një ftesë zyrtare për trajtim në KK, e kam pa të arsyeshme kjo çështje të trajtohet në KK. Njëjtë kemi vepruar edhe për vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri në vitin 2019, ndërkaq varet nga ju sesi do ti përgjigjemi kësaj ftese. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Faleminderit kryesues; Për mendimin tim këto vizita janë ekskursione me paratë e taksapaguesve. Unë nuk do të vijë në këtë vizitë, ndërkaq kur kjo çështje të shtrohet në votim, konfirmoj së do të votoj kundër.

Kryesuesi i Kuvendit, Në rregull, është mendimi i juaj Ekrem, ne e trajtojmë ndryshe, ndërkaq kërkoj nga subjektet politike të prononcohen se a janë për realizimin e vizitës zyrtare.

z. Ekrem Kyçyku, Ne do të abstenojmë kur të votohet kjo çështje, ndërkaq do të mbetet në vullnetin e secilit anëtar të LVV së a do të merr pjesë në vizitë zyrtare apo jo.

z. Nexhat Loku, Në emër të GP të PDK jemi për realizimin e vizitës zyrtare si në ftesë.

z. Selim Reka, Ne mendojmë së çdo vizitë që bëhet, është në të mirën e komunës tonë, sepse bëhet shkëmbimi i përvojave të KK. Ne subjekti politik i LDK do të përkrahim realizimin e vizitës zyrtare.

znj. Hafize Sallahi, Pasi që edhe komunat tjera zhvillojnë aktivitete të tilla, ne subjekti politik i AAK do të përkrahim realizimin e kësaj vizite.

z. Bekim Koxha, Ne subjekti politik i NISMA edhe me herët i kemi përkrahur vizitat e tilla të cilat i kemi realizuar, edhe tani e përkrahim realizimin e kësaj vizite.

Kryesuesi i Kuvendit, Propozimin – Ftesën e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Strugës, për një vizitë zyrtare të Këshilltarëve të KK Kaçanik, në Komunën e Strugës e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishte 1 Ekrem Raka, Abstenuan 7 anëtarët nga LVV. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për realizimin e një vizite zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në Komunën e Strugës me datën 8 dhe 9 Korrik 2021, me ftesën e Komunës së Strugës/ Lënda: 01Nr. 60/01-15767/21.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 11:25. Deri fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarët-të gjithë, sa ishin edhe në fillim të mbledhjes.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 30.06.2021

Për: Anëtarin e Kuvendit/ z. Selim Reka

Lënda: PËRGJIGJE

I nderuar,


Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 10.06.2021, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

z. Selim Reka, Në rrugën A2, a ka diçka të re?, Në këtë rrugë është punuar një kohë prej ministrie dhe ka kohë që kanë ngecë punimet. Nuk e di a është bërë diçka në këtë drejtim? 2. Edhe një pyetje ose kërkesë për DSHPE; Dihet se parkingjet të dielave nuk paguhen. Kishte me qenë mirë që kjo të bëhet edhe për festa. Më herët edhe për festa nuk janë paguar parkingjet. Kërkoj të rregullohet kjo çështje, në mënyrë që qytetarët të mos pagujnë për parkingje në ditët e festave.

- Punimet në projektin "Ndërtimi i rrugës që lidh pjesën jugore të Kaçanikut me rrugën N2" apo vazhdimi i rrugës "Idriz Seferi" janë udhëhequr nga Ministria e Infrastrukturës. Ministria ka ndërprerë kontratën me Operatorin e mëparshëm Ekonomik. Nga viti 2017 deri 2021 ky projekt është i koduar në buxhetin për investime kapitale të Ministrisë dhe në vazhdimësi janë ndarë mjetet për këtë projekt por nuk janë udhëhequr procedura të reja për finalizim të pjesës së mbetur, përkundër inistimit të vazhdueshëm nga komuna.*
Këtë vit, në buxhetin për investime kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës janë të ndara 176,975.00€ për finalizim të këtij projekti dhe më dt. 19.03.2021 është nënshkruar Memorandum i Mirëkuptimit mes komunës së Kaçanikut dhe Ministrisë së Infrstrukturës (Nr. i prot. 02-2412 i datës 19.03.2021) dhe është mundësuar që procedurat e reja të prokurimit të udhëhiqen nga komuna e Kaçanikut. Pas ndryshimeve në qeverisjen qendrore, kjo ministri ka pezulluar të gjitha Memorandumet mes ministrisë dhe komunave të nënshkruara në vitin 2021 (në mesin e tyre edhe Memorandumin mes komunës sonë) pa ndonjë arsytim përkundër që mjetet buxhetore janë të ndara dhe të koduara për këtë projekt në buxhetin e Republikës së Kosovës.
- Përmes Shpalljes Publike, është përzgjedhur kompania për menaxhimin e parkingjeve në bulevardin "Ismajl Raka" për periudhën njëvjeçare. Pasiqë në kontakt me operatorin nuk është potencuar ky detal, ne nuk mund t'i këkojmë operatorit që për festa të mos aplikohet pagesa e parkingut. Pas skadimit të kësaj kontrate, do të shqyrtohet mundësia që me kontratën e re, të parashihet ky detal.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,


Ramadush Osmani
Drejtor i DSHPE-s



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

- Kuvendi i Komunës-

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK
(zgjedhur në votimet e 22 Tetorit 2017)

Evidenca e pjesëmarrjes së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e VI-të (Gjashtë) të Rregullt për vitin 2021, mbajtur më 15 Qershor 2021

1	2	3	4	5
Nr. R	Emri dhe Mbiemri	pozita	Përkatësia Politike	Nënshkrimi
01.	Hamid Guri	anëtar	PDK	
02.	Ahmet Luma	"	PDK	
03.	Kadri Krivenjeva	"	PDK	
04.	Besim Vishi	"	Nga PDK/ në LVV	
05.	Sali Malsiu	"	PDK	
06.	Lirije Dema	"	PDK	
07.	Pranverë Loku-Zharku	"	PDK	
08.	Lirije Luta	"	PDK	
09.	Vlora Dalloshi	"	PDK	
10.	Nexhat Loku	"	PDK	
11.	Agim Mani	"	LVV	
12.	Adnan Reka	"	LVV	
13.	Ekrem Kocyku	"	LVV	
14.	Fatijona Kocyku	"	LVV	
15.	Kaltrina Kodra	"	LVV	
16.	Selim Reka	"	LDK	
17.	Besnik Salihu	"	LDK	
18.	Nazife Krasniqi	"	LDK	
19.	Arlinda Rakoci-Raka	"	LDK	
20.	Shemsedin Luzha	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur (GP) nga GP/ i Pavarur/ i Pavarur nga i Pavarur në LVV-	
21.	Albana Lika	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur (GP) Nga GP në LVV	
22.	Rabije Sallahi	"	AAK	
23.	Hajredin Luta	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur	
24.	Hafize Sallahi	"	Nga NISMA/ në AAK	
25.	Bekim Koxha	"	NISMA	
26.	Ekrem Raka	"	IQ Lista për Kaçanikun	

Vërtetoj: Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e VI-të (Gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2021, mbajtur me 15.06.2021

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Dema.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Kodra.....,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Lika.....,
23. Rabije Sallahi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,......